

INPO

Initiative for progress

HULUMTIM

SHUMICA E QYTETAREVE FERIZAJAS
DEKLAROHEN KUNDER SHTYRJES
SË ZGJEDHJEVE LOKALE 2006

REZULTATET E HULUMTIMIT

MAJ 2006

PËRMBAJTJA

Përmbledhje 3

Grafika 6

Pyetësori 9

PËRMBLEDHJE

Ferizaj, 05 MAJ 2006

NPO gjatë muajit maj realizoi një pyetësor me 100 qytetar ferizajas për të kuptuar qëndrimin e këtyre të fundit rreth temës më aktuale, asaj të shtyrjes apo jo, të zgjedhjeve lokale të këtij viti. Ky aktivitet ka zgjatur një javë. Mostra reprezentive është 100. Është realizuar në dy mënyra: 20% e respondentëve kanë qenë të selektuar kurse 80% e pyetësorëve janë realizuar me respondentë të rastit. Në kuadër të grupit të selektuar që gjithsej kanë qenë 18, kanë qenë të persona të profesioneve të ndryshme si: profesor, përfaqësues të partive politike, studentë dhe punonjës të institucioneve publike.

Pyetësi ka pasur gjithsej 6-pyetje të cilat i janë dedikuar zgjedhjeve lokale. Nga analiza e bërë, kemi arritur të kuptojmë disa gjëra rreth mentalitetit aktual politik të qytetarëve në raport me zgjedhjet. Mirëpo më lejoni që ne fillim t'ju informoj rreth

rezultateve të pyetësorit: Sa l përket, qëndrimin të qytetarëve ferizajas rreth shtyrjes apo jo të zgjedhjeve, 50% janë deklaruar kundër shtyrjes kundrejt 46% që e përkrahin këtë, kurse 4% janë shprehur se nuk kanë opinion rreth kësaj çështjeje. Arsyeja kryesore për 46%-shin për shtyrjen e zgjedhjeve është statusi i cili ka marr 86% kundrejt disa arsyeve tjera si: gjendja e rëndë aktuale, rritja e numrit të votuesve dhe jo-arsyeshmëria në raport me gjendjen aktuale.

86% e të anketuarve janë shprehur se zgjedhjet e ardhshme lokale duhet të jenë me lista të hapura kundrejt 10% që mendojnë ndryshe, pra me lista të mbyllura. 4% nuk kanë pasur opinion rreth kësaj pyetje. Poqëse zgjedhjet lokale do të mbaheshin këtë vit 77% e të anketuarve do të merrnin pjesë në to. 20% e tyre nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme

lokale, dhe 3% nuk kane opinion. Arsyeja kryesore përse 20% nuk do të marrin pjesë në zgjedhje: është se nuk janë të kënaqur me punën e deritanishme të tyre kjo e shprehur me 40% me të njëjtën përqindje gjithashtu ata janë shprehur se asnjë parti nuk i përfaqëson ata. Kurse 20% janë deklaruar se nuk i besojnë partive politike andaj nuk do të marrin pjesë në zgjedhje.

Shtyrja e zgjedhjeve nga ata është cilësuar si pozitive me 39%, negative 29%, jo demokratike 10% dhe e dëmshme 22%. Pra nëse bëhet një sub-analizë këtu vërehet se 61% e respondentëve vlerësojnë se shtyrja e zgjedhjeve do të ketë efekte jo të mira. Ndërmjet respondentëve të selektuar dhe atyre të rastit vërehet një dallim i qëndrimeve sa i përket shtyrjes apo jo të zgjedhjeve. Respondentët e selektuar me 50% nuk përkrahin shtyrjen e zgjedhjeve, kundrejt 39% që e përkrahin. Tani tek respondentët e rastit përqindja është e njëjtë pra 48% për ti shtyrë dhe 48% për ti mos shtyrë. Gjithashtu një dallim tjetër në mes

këtyre grupeve është qëndrimi rreth mënyrës së zgjedhjeve me lista të hapura apo të mbyllura. Tek respondentët e selektuar 100% kërkojnë lista të hapura kundrejt atyre të rastit me vetëm 83%.

Sa i përket pjesëmarrjes në zgjedhje 72% e respondentëve të selektuar do të marrin pjesë në zgjedhje kundrejt 79% të rastit. Kjo është për tu habitur, sepse paragjykohet se profesorët, politikanët, dhe studentët janë më të vetëdijshëm për përgjegjësitë që i kanë në një shoqëri demokratike në mesin e të cilave është edhe votim. Mirëpo me sa duket, këta të fundit, janë zhgënjyer thellë nga puna e qeverisë. Si do që të jetë ky rezultat na paralajmëron për një rënie të madhe të numrit të njerëzve që do të dalin në zgjedhje. Nëse, intelektualët nuk dalin në zgjedhje, ne çfarë do të presim nga qytetarët e tjerë.

Ne kemi synuar gjithashtu të kuptojmë disponimin aktual të qytetarëve për


pjesëmarrje në zgjedhje, dhe me sa duket në një mënyrë paragjykimi ynë se disponimi aktual i qytetarëve për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme lokale nuk është në nivel të kënaqshëm. Në bazë të rezultateve të pyetësorit, ne kemi arritur në përfundim se, gjendja aktuale socio-politike është tejte e rëndë. Kjo gjendje nëse nuk adresohet tani dhe në mënyrë efikase, rrezikon destabilizimin e shoqërisë, përkatësisht mund të themi një Shqipëri të '97 në Kosovë. Dhe shtyrja e zgjedhjeve do ti kontribuonte keqësimit të gjendjes socio-politike duke krijuar institucione pa baze në popull, duke përkrahur programe pa përkrahjen e votuesve dhe duke e zbehur parimin e llogari-dhënies. Një përfundim tjetër është niveli i lartë i pa-kënaqësisë së qytetarëve në raport me punën e partive politike dhe ngritja e numrit të atyre që nuk i besojnë partive politike dhe nuk mendojnë se ato i përfaqësojnë ata. Ky është indikator i fortë i punës së dobët të të gjitha partive politike, ne veçanti atyre që përfaqësohen ne

Kuvendin Komunal. Patjetër që rekomandimi kryesor do të ishte, dizajnimi i programeve që adresojnë problemet e rënda sociale, mirëpo që puna e tyre do të mbështetej jo në burime monetare të jashtme por më shumë në koordinimin dhe rrjetëzimin e burimeve të brendshme. Zgjedhjet me lista të hapura nuk janë më vetëm një kërkesë e arsyeshme por janë një nevojë, një normë e pa-diskutueshme që duhet të aplikohet. Kjo do të siguronte një stabilizim politik të shoqërisë.


Apelojmë tek partitë politike që të jenë më të kujdesshme dhe të përfaqësojnë interesin e qytetarit dhe të mos ngrehin shqetësime të pabaza politike që destabilizojnë rëndë shoqërinë dhe raportet ndërmjet njerëzve duke u thirrur në ndarje partiake. Thërrasim qeverinë lokale, që të mos mbështet shumë në buxhetin vetanak duke u përdorur nganjëherë edhe si shfajësim, por të aktivizohet në përdorimin e burimeve interne për ti zgjidhur problemet.

GRAFIKAT


1) A mendoni se duhet të shtyhen zgjedhjet lokale?




2) Nëse po, pse?




3) A duhet që zgjedhjet lokale të jenë me lista të hapura?




4) A do të merrni pjesë në zgjedhjet lokale po që se mbahen këtë vit?



5) Nëse jo, pse ?



6) Nëse do të shtyhen zgjedhjet a mendoni se kjo është :



PYETËSOR

“Shtyrja e Zgjedhjeve Lokale 2006”

1) A mendoni se duhet të shtyhen zgjedhjet lokale?

PO

JO

NUK E DI

2) Nëse po, pse?

3) A duhet që zgjedhjet lokale të jenë me lista të hapura?

PO

JO

NUK E DI

4) A do të merrni pjesë në zgjedhjet lokale po që se mbahen këtë vit?

PO

JO

NUK E DI

5) Nëse jo, pse ?

- a) Nuk i besoni partive politike,
- b) Nuk jeni të kënaqur me punën e deritashme të tyre,
- c) Asnjë parti politike nuk ju përfaqëson ashtu siç duhet.

6) Nëse do të shtyhen zgjedhjet a mendoni se kjo është :

- a) Pozitive
- b) Negative
- c) Jo demokratike
- d) E dëmshme

Numri i pyetësorit: _____ Data: _____ Koha: _____

Emri dhe mbiemri i intervistuesit: _____ Nënshkrimi: _____